

VENDIM
Nr.569, datë 12.8.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË FATMIR BEHAJ, FATBARDHA BEHAJ DHE DENIS BEHAJ, NË MOSKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të Fatmir Behaj, Fatbardha Behaj dhe Denis Behaj, në Moskë.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano